



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KËLCYRË

Këlcyrë më, _____.____.2026

PROCESVERBAL

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM PËR PROCEDURËN E PROKURIMIT PROCEDURE
E HAPUR-MALLRA, PROKURIM ELEKTRONIK**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: Blerje karburant për Bashkinë Këlcyrë dhe institucionet në varësi për vitin 2025.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Kodi PCV 09134100-8 (Karburant diesel)

VLERA E FONDIT LIMIT:

Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: **3,014,704** (tre milion e e katerbedhete mije e shtateqind e kater) **lekë pa tvsh.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Këlcyrë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas **Shtojcës 9**;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas **Shtojcës 3**;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 77, 82 dhe 83 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si edhe nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, njësia e prokurimit bazuar në natyrën e kontratës, si edhe preventivin, gjykon që pjesë e kriterëve të vecanta për kualifikim të jenë dhe kriteret e tjera teknike, me qëllimin kryesor

që t'i shërbejë autoritetit kontraktor ndër të tjera për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve teknike, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, reputacionin dhe besueshmërinë, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës, konkretisht njësia e prokurimit gjykon vendosjen e kritereve si vijon:

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kritereve të Përgjithshme (Vetëdeklarim, sipas shtojcës 8)

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, si edhe në nenin 40 dhe nenin 42 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.*

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron minimale vjetore për 3 vitet e fundit financiar ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 30% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP i ndryshuar, si dhe nenet 43 e 55, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (c) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formes elektronike".

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar se ky kriter kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 15 % të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

ose

- b. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si edhe nenit 55, pika 4 gërma b) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Me anë të këtij kriteri, kërkohet që operatorët ekonomikë, të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 15% të vlerës së fondit limit që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Vlera e kërkuar, është vendosur që t’i shërbejë autoritetit kontraktor, për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur, duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme si dhe përvojën e duhur, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Përvoja e mëparshme, është element shumë i nevojshëm, që garantojnë Autoritetin Kontraktor, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së furnizimeve të ngjashme, zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizim/leje të ushtrimit të aktivitetit (Tregtim me pakicë karburantesh) të lëshuar nga Njësitë e Qeverisjes Vendore dhe që plotëson kushtet e legjislacionit në fuqi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 40, pika 5, gërma a) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i cili përcakton se: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/entikontraktor kërkon: a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekti kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore. Gjithashtu kjo

kërkesë është bazuar dhe në Ligjin Nr.8450 dt.24.02.1999 “Për përpunimin, transportin dhe tregëtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre” si dhe në VKM nr.970 datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregëtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” I ndryshuar.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të disponoj minimumi një pikë karburanti në një distancë tokësore jo më larg se 20 km nga Bashkia Këlcyrë (vërtetuar me një nga format e disponimit sipas Kodit Civil (akt pronësie, kontratë qeraje ose marrëveshje bashkëpunimi/ furnizimi, të pasqyruara në ekstraktin e regjistrimit tregtar lëshuar nga QKB ose kontratë bashkëpunimi noteriale për gjithë kohëzgjatjen e kontratës), në përmbushje të nevojave të vazhdueshme dhe në mënyrë të leverdisshme për Autoritetin Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë me dokumente konkrete për përmbushjen e këtyre kriterëve.

Vendosja e këtij kriteri është e rëndësishme për autoritetin, për të vërtetuar qëndrueshmërinë e ofertuesit, dhe besueshmërinë në përmbushjen e sukseshme të kontratës.

Ky kriter është i nevojshëm dhe i arsyeshëm për autoritetin kontraktor, duke përmbushur nevojat e saj në mënyrë të leverdisshme për Bashkinë Këlcyrë. Njësia e prokurimit e ka lënë të hapur plotësimin e këtij kriteri për operatorët ekonomik ofertues, se në rastin që nuk disponojnë një pikë karburanti në një distancë tokësore jo më larg se 20 km nga Bashkia Kuçovë, duke vërtetuar me një nga format e disponimit sipas Kodit Civil.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë që garanton dhe është i disponueshëm për furnizimin 24/24 për 7 ditë të javës.

Argumentimi: Kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet ekonomike dhe financiare, **kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative**, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin **dhe besueshmërinë**, përvojën e duhur, **si dhe personelin e nevojshëm**, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës.

Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet dhe të vërtetohet që operatori ekonomik gëzon dhe zotëron kapacitetin teknik, duke krijuar bindjen tek Autoriteti Kontraktor se operatori ekonomik kontraktues do të realizojë kontratën me sukses.

Gjithashtu theksojmë se në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Rregullat e Prokurimit Publik”I ndryshuar parashikon instrumenta të tjerë në mënyrë që operatorët ekonomikë të bëhen pjesë e procedurave të prokurimit public që zhvillojnë Autoritetet Kontraktore.

Konkretisht në nenin 88 të VKM-së nr.285 , datë 19.05.2021”Rregullat e Prokurimit Publik”I ndryshuar jep mundësinë operatorëve ekonomikë që të bëhen pjesë e procedurave të prokurimit të zhvilluara nga AK edhe nëpërmjet bashkimit të operatorëve ekonomikë.

2.3.5 Ne zbatim të Vendimit të Keshillit të Ministrave nr.561, datë 29.07.2016 “Për standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njesite të qeverisjes së shpenzimeve ”operatori fitues në këtë procedurë prokurimi duhet të kryejë furnizimin me karburant të mjeteve nepermjet kartave elektronike

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Në të gjitha rastet kur përmendet certifikatë, markë, emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjine specifike, prodhues ose sipërmarrës pranohet edhe ekuivalent i tyre.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Specifikimet teknike të Gazoil 10 ppm ULSD sipas standartit SSH EN 590:2022 ose ekuivalente

Nr	Emërtimi	Njësia	Kufijtë e lejuar		Metoda e Testimit
			Min	Max	
1	Numri i Cetanit		51	-	SSH EN ISO 5165 SSH EN 16144 SSH EN 5195 EN 16715
2	Indeksi i Cetanit		46.0	-	SSH EN ISO 4264
3	Densiteti në 15°C	Kg/m ³	820	845	EN ISO 3675 EN ISO 12185
4	Hidrokarbure Aromatike Policiklike	% (m/m)	-	8	SSH EN ISO 12916

5	Përmbajtja e Squfurit	mg/kg	-	10.0	SSH EN ISO 20846 SSH EN ISO 13032 SSH EN ISO 20884
6	Përmbajtja e Manganit, nga 01.01.2014 e në vazhdim	mg/l	-	2	SSH EN ISO 16576
7	Pika e Ndezjes	°C	Mbi 55		SSH EN ISO 2719
8	Mbetje Karboni (ne 10% mbetje destilimi)	% (m/m)	-	0,30	SSH EN ISO 10370
9	Përmbajtja e Hirit	% (m/m)	-	0,01	SSH EN ISO 6245
10	Përmbajtja e Ujit	mg/kg	-	200	SSH EN ISO 12937
11	Kontaminimi Total	mg/kg	-	24	SSH EN ISO 12662
12	Gryerja e shiritit të bakrit (3 orë në 50 ⁰ C)	grada	KLASI I		SSH EN ISO 2160
13	Përmbajtja e acidit të ngopur metilester	% (vV/V)	-	7	SSH EN 14078
14	Qëndrueshmëria e oksidimit	g/m ³ _h	20	25	SSH EN ISO 12205 SSH EN 15751
15	Lubrifikimi, diametrik i veshjes së mprehtë (ësd 1,4) në 60 °C	um(microm)	-	460	SSH EN ISO 12156-1
16	Viskozitetit në 40 ⁰ C		2,000	4,500	SSH EN ISO 3104
17	Destilimi %vol e destilati qe vlon deri ne 250°C %vol e destilati qe vlon deri ne 350°C Distilati qe vlon ne 95 % vol.	%(v/v) %(V/V) °C	85	<65 360	SSH EN ISO 3405 SSH EN ISO 3924

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Garancia

Kontraktuesi mban përgjegjësi për kualitetin në bazë të parametrave të karburantit.

Nëse do të konstatohen se karburanti nuk plotëson karakteristikat dhe parametrat teknike të përcaktuara më lartë, ai detyrohet të zëvendësojë sasinë e reklamuar dhe të furnizuar të karburantit.

Bashkëlidhur këtij procesverballi:
Dokumentat e tenderit.

Në përfundim, Njësia e Prokurimit vendosi unanimisht miratimin e dokumenteve të tenderit dhe si afat përfundimtar për dorëzimin e ofertave përcaktoi datën .26.02.2026, ora.09.00

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt: “Blerje karburant për Bashkinë Këlcyrë dhe institucionet në varësi për vitin 2026”.

Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurimin anëtar në NJP.
Bashkëlidhur këtij procesverbali:
Dokumentat e tenderit.

NJËSIA E PROKURIMIT
